



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.1, nenit 5 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5, nenit 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 06.07.2022, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-2618/22, për zyrtarin e lartë publik z. Visar Korenica, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, për shkak se është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

III. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin për konflikt të mundshëm interesi në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë z. Visar Korenica, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr.06/L-011, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (tutje: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia kundër Korrupsionit sipas detyrës zyrtare ka iniciuar procedurën për trajtimin e rastit të mundshëm të konfliktit të interesit, sipas të cilit z. Korenica duke qenë zyrtarë i lartë publik, respektivisht, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës, njëkohësisht mbante edhe funksionin e kryetarit në organizatën joqeveritare “Iniciativa Pozitive”.

Për t'i vërtetuar gjetjet, Agjencia kundër Korrupsionit ka kërkuar informata dhe dokumentacion nga Departamenti i Organizatave Joqeveritare në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Nga informatat e pranuar përmes shkresës zyrtare me numër DPKI-06-2618/21 është konstatuar se z. Korenica e mban funksionin e kryetarit në organizatën joqeveritare, “Iniciativa Pozitive”, situatë kjo e cila bie ndesh me nenin 14, paragrafi 1 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit.

Lidhur me këtë, Agjencia kundër Korrupsionit e ka njoftuar zyrtarin e lartë me shkresë zyrtare nr. AKK-DPKI-06-02/2294/22 për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së konfliktit të interesit.

1/2



Pas dërgimit të kësaj shkrese, Agjencia kundër Korrupsionit ka kontaktuar me z. Korenica, dhe e ka njoftuar atë se gjatë ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, nuk mundet që njëkohësisht të ushtroj edhe funksion drejtues, respektivisht, atë të kryetarit në organizata joqeveritare, pasi që një gjë e tillë bie ndesh me nenin 14 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, i cili përcakton se:

“1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues, me përjashtim të funksionit drejtues, të organizatës joqeveritare nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës, veprimtarive humanitare dhe të ngjashme pa të drejtë shpërblimi me pagesë, përveç të drejtës në kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit dhe shpenzimeve të tjera të lidhura me to.

2. Organizata joqeveritare sipas paragrafit 1. të këtij neni nuk ka të drejtë të lidhë kontratë ose të përfitojë fonde nga institucioni ku ushtron detyrën zyrtari që është anëtar i organit drejtues në këtë organizatë.”

Zyrtari i lartë, është pajtuar me konstatimet e Agjencisë kundër Korrupsionit dhe ka premtuar se do të ndër marrë veprime në mënyrë që ta shmang gjendjen e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, Agjencia kundër Korrupsionit ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-2785/22) me Letërkonfirmim, në bazë të së cilës dëshmohet se zyrtari i lartë, ka ndër marr veprimet e nevojshme konform nenit 19, paragrafit 1, nën-paragrafit 1.3. të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, duke u dorëhequr nga funksioni drejtues në organizatën joqeveritare.

Me veprimet e ndër marra nga z. Korenica, është shmangur gjendja e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik. Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

III. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPKI - së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Yll BULESHKAJ
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

